

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtaren e vetme gjykuese Fatime Dermaku, me zyrtaren ligjore Edona Grajçevci, procesmbajtëse, në çështjen penale, kundër të pandehurve: F. R. , Z. R., Nj. R. dhe Sh. D. për shkak të veprës penale Vjedhje në tentativë nga neni 325 par 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.6864/2013 të datës 23.03.2016, të cilën e përfaqësonte Prokurorja e Shtetit Shenaj Berisha, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 07.12.2017, mori dhe publikisht shpalli në të njëjtën ditë këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri F. R., i biri i F. dhe nënës H., e vajzërisë D., i lindur me *data e lindjes...*, në P. ,me vendbanim në fsh M. e E. –F. K. me nr te tel . *numri i telefonit...* me nr. personal *numri personal...*, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i dy fëmijëve, i punësuar ndërtimtari, gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës.

I pandehuri Z. R., i biri i F. dhe nënës Sh., e vajzërisë K., i lindur me *data e lindjes...*, në P. ,me vendbanim në fsh M. e E. –F. K. me nr te tel *numri i telefonit...* me nr. personal *numri personal...* , ka të kryer shkollën fillore , i pa martuar, , i pa punë , gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës.

I pandehuri Nj. R., i biri i I. dhe nënës A., e vajzërisë D., i lindur me *data e lindjes...*, në P., me vendbanim në fsh M. e E. –F. K. me nr te tel. *Numri i telefonit...* me nr. personal *numri personal...*, ka të kryer shkollën e mesme i martuar, i punësuar baba i një fëmije, gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës.

I pandehuri Sh. D., i biri i A. dhe nënës R., e vajzërisë I., i lindur me *data e lindjes...*, në fsh M. e E. – F. K. ku edhe tani jeton me nr. te tel. *Numri i telefonit...*, me nr. personal *numri personal...*, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i dy fëmijëve, i punësuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTORË

Sepse me datë 27.09.2013, rreth orës 16:20h, në fshatin M. e E., KK F. K., saktësisht në Terminalin e kompanisë “J. O.”, të pandehurit secili veç e veç, me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtëshme vetës apo personit tjetër t’i sjellin dobi pasurore të kundërligjshme, kanë shkuar tek terminali i kompanisë“J. O.”, për të marrë naftën nga vagonat e trenit të cilët janë shkarkuar, dhe kanë tentuar që të marrin naftë, por, pasi që janë vërejtur nga policia kanë ikur nga vendi i ngjarjes, dhe në vendin e ngjarjes është arritur të ndalohet i pandehuri F. R., si dhe janë gjetur 9 kanta të llojev etë ndryshme dhe rreth 70 litra naftë,

-me këtë secili veç e veç ka kryer veprën penale Vjedhje në tentativë nga neni 325 par 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Andaj, gjyqtarja e vetme gjykuese, në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 51,52, 62 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 7, 69, 73,74,75 dhe 76 të KPRK, si dhe nenit 248 dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale,¹ të pandehurve: F. R. , Z. R., Nj. R. dhe Sh. D., seciliot veç e veçi shqipton :

¹ Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejme KPP), nr.04/L-123, i datës 13.12.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

GJYKIM ME KUSHT

- Ashtu që të pandehurve: F. R., Z. R., Nj. R. dhe Sh. D., secilit veç e veçi, i caktohet dënimi me burg kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, të cilin dënim të pandehurit nuk do ta mbajnë, nëse në afat prej 1(një) viti, nga dita kur aktgjykimi merr formë të prerë nuk kryejnë ndonjë veprë tjetër penale.
- Dënim me gjobë në shumën prej 100€, secilit veç e veç, të cilin nuk do t'a paguajnë nëse në afat prej 1 (një) viti nuk kryejnë veprë të re penale, Nëse revokohet dënimi me gjobë dhe të pandehurit nuk munden apo nuk do t'a përmbushin atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim edhe atë për 20€, të dënimit me gjobë do të vuaj një ditë burg.
- të pandehurit, secili veç e veç, obligohet që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë 20 €, në emër të paushallit gjyqësor dhe shpenzimet tjera sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate.

ARSYETIMI

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, më datë 01.08.2014, ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.6864/2013 të datës 23.03.2016, ndaj të pandehurve: F. R. , Z. R., Nj. R. dhe Sh. D., secili veç e veç, për shkak të veprës penale Vjedhje në tentativë nga neni 325 par 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Pas pranimit të aktakuzës, gjyqtarja e vetme gjykuese, e ka caktuar shqyrtimin fillestar për datën 07.12.2017, ku është lexuar aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit dhe pas leximit të aktakuzës, të pandehurit (secili veç e veç), kanë deklaruar se e kanë kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohen duke shtuar se (secili veç e veç), e pranojë fajësinë për kryerjen e kësaj veprë penale.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik, gjyqtarja e vetme gjykuese pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, gjyqtarja e vetme gjykuese, ka konstatuar secili i pandehur e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga të pandehurit, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjyqtarja e vetme gjykuese e ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

- se të pandehurit: F. R. , Z. R., Nj. R. dhe Sh. D., secili veç e veç, me dashje e kanë kryer veprën penale Vjedhje në tentativë nga neni 325 par 1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 325 par.1 të KPRK, është parashikuar se formën themelore të veprës penale të vjedhjes e kryen “Kushdo që personit tjetër ia merr pasurinë e cila vlerësohet në shumën prej pesëdhjetë (50) Euro apo më shumë, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet”

Kështu që duke u bazuar në këto dispozita ligjore, gjyqtarja e vetme gjykuese, i ka shpallur fajtor të pandehurin : F. R. , Z. R., Nj. R. dhe Sh. D., secilin veç e veç, për shkak të veprës penale të Vjedhjes në tentativë nga neni 325 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, ngase në veprimet e të njëjtit konsumohen të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe se për të njëjtat secili veç e veç është edhe penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se siç e kanë pranuar edhe vetë, të njëjtit ditën kritike, me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtëshme vetës apo personit tjetër t’i sjellin dobi pasurore të kundërligjshme, kanë shkuar tek terminali i kompanisë“J. O.”, për të marrë naftën nga vagonat e trenit të cilët janë shkarkuar, dhe kanë tentuar që të marrin naftë, por, pasi që janë vërejtur nga policia kanë ikur nga vendi i ngjarjes, dhe në vendin e ngjarjes është arritur të ndalohet i pandehuri F. R..

5. Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjyqtarja e vetme gjykuese, ka vendosur që të pandehurit F. R. , Z. R., Nj. R. dhe Sh. D., secilin veç e veç, t’a shpall fajtor për kryerjen e veprës penale sipas aktakuzës së lartcekur meqenëse u vërtetua se I njëjtit e kanë kryer veprën penale siç edhe vet e kanë paratur sikurse në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit dhe për të njëjtin është përgjegjës.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Duke u bazuar në nenin 73 dhe 74 të KPRK, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurve, për secilin veç e veç, gjyqtarja e vetme gjykuese, i ka marrë për bazë disa rrethana që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese për të pandehurit, gjyqtarja e vetme gjykuese, i ka marrë për bazë sjelljet e mira të pandehurve gjatë shqyrtimit fillestar; pranimin e fajësisë; se sipas deklaratës së të pandehurve, të cilave gjyqtarja e vetme gjykuese, ja fali besimin, të njëjtit janë penduar për kryerjen e kësaj vepre penale dhe se kanë premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejnë ndonjë vepër tjetër penale; si dhe faktin se më parë nuk kanë qenë të dënuar për ndonjë vepër tjetër penale dhe ndaj tyre, nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale, poashtu Prokurorja e Shtetit i ka propozuar Gjykatës që t’a merr si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë nga të pandehurit. Gjithashtu, me rastin e shqiptimit të dënimit me burg në kohëzgjatje prej 3 muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej një viti nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, si dhe dënimin me gjobë në shumën prej 100€, të cilën nuk do t’a paguajnë nëse në afat prej 1 (një) viti secili veç e veç, nuk kryen vepër të re penale, Nëse revokohet dënime me gjobë dhe të pandehurit secili veç e veç, nuk mundet apo nuk do t’a përmbush atëherë dënimi me gjobë do t’i zëvendësohet me dënim me burgim edhe atë për 20 €, të dënimit me gjobë do të vuaj një ditë burg, gjyqtarja e vetme gjykuese e ka marrë për bazë edhe gjendjen pasurore të pandehurve dhe të ardhurat e tyre, meqenëse siç e theksuam më lartë të pandehurit janë të gjendjes ekonomike të dobët, ndërsa, gjyqtarja e vetme gjykuese, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese në këtë çështje penale.

7. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjyqtarja e vetme gjykuese, me rastin e shqiptimit të dënimit me burg në kohëzgjatje prej 3 muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej një viti nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë, të pandehurit secili veç e veç, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, si dhe dënimin me gjobë në shumën prej 100€, të cilën nuk do t’a paguajnë nëse në afat prej 1 (një) viti nuk kryen vepër të re penale, Nëse revokohet dënime me gjobë dhe të pandehurit secili veç e veç, nuk mundet apo nuk do t’a përmbush atëherë dënimi me gjobë do t’i zëvendësohet me dënim me burgim edhe atë për 20 €, të

dënimit me gjobë do të vuaj një ditë burg, ndaj të pandehurve F. R. , Z. R., Nj. R. dhe Sh. D., duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

8.Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të pandehurv, për secilin veç e veç, gjyqtarja e vetme gjykuese, duke u bazuar nënin 451 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurit secilin veç e veç, ta detyrojë për ta paguar paushallin gjyqësor në shumë prej 20 Euro si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.1496/16
Më 07.12.2017

Zyrtarja ligjore,
Edona Grajçevci

Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Fatime Dërmaku

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimin të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.